

Aneksi 5 – Kriteret e Kualifikimit dhe Pranueshmërisë

1. Emri dhe adresa e kompanisë / Numri i regjistrimit në Regjistrin Tregtar

2. Kompania është e regjistruar ligjërisht dhe e autorizuar për të ushtruar aktivitetin profesional të nevojshëm për realizimin e punës që është objekt i kësaj kërkesë për ofertë. Ju lutemi, paraqisni një ekstrakt nga QKB-ja.

3. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar nuk duhet të jetë më e vogël se 10,000,000 lekë.

4. Certifikatë/Konfirmim për pagesën e detyrimeve tatimore në përputhje me legjislacionin në fuqi;

5. Certifikatë/Konfirmim për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore në përputhje me legjislacionin në fuqi;

6 Certifikatë që konfirmon pagesën e të gjitha detyrimeve të energjisë elektrike të maturuara;

7. Numri i punonjësve – Ju lutemi paraqisni një dokument zyrtar që vërteton numrin e punonjësve për vitet e sipërpërmendura, duke dëshmuar se të paktën 5 (pesë) punonjës të përhershëm kanë qenë të regjistruar në secilin prej tre viteve të fundit (mesatarja për vitin 2023, mesatarja për vitin 2024 dhe mesatarja për vitin 2025). Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vërtetim të lëshuar nga Dega e Tatim Taksave ose Dega e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetsore në të cilin të jetë i percaktuar numri i punonjësve të siguruar për periudhën e mësipërme.

8. Operatori ekonomik duhet të dëshmojë disponueshmërinë e ekspertëve kryesorë të mëposhtëm, në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe eksperiencës të percaktuara në Termat e Referencës:

- Drejtues Ekipi
- Ekspert për Vlerësimin e Riskut nga Përmbytjet
- Ekspert për Vlerësimin e Riskut nga Rrëshqitjet e Dherave dhe Riskut Sizmik
- Ekspert për Vlerësimin e Riskut nga Zjarret në Pyje
- Ekspert për Riskun Teknologjik dhe Industrial
- Ekspert për Riskun Biologjik dhe Sëmundjet Infektive
- Ekspert GIS dhe Hartëzimit të Riskut
- Ekspert Socio-Ekonomik
- Ekspert për Zhvillimin Vendor

Operatori ekonomik duhet të paraqesë Curriculum Vitae (CV) të ekspertëve, kopje të diplomës, kualifikime përkatës. Operatori ekonomik duhet gjithashtu të paraqesë një deklaratë që konfirmon se ekspertet e propozuar do të jenë të disponueshëm dhe të angazhuar gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.

Gjithashtu, operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ekspertet e propozuar kanë marrëdhënie ligjore me kompaninë, nëpërmjet kontratës së punës, kontratës së shërbimit, marrëveshjes së bashkëpunimit ose një forme tjetër të njohur ligjërisht të angazhimit, dhe duhet të paraqesë dokumentacionin përkatës mbështetës dhe dokumentacioni mbështetës përkatës duhet të dorëzohen si pjesë e ofertës teknike.

9. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për të paktën 3 (tre) projekte reference në fushën teknike përkatëse (Reduktimi i Riskut nga Fatkeqësitë/Adaptimi ndaj Ndryshimeve Klimatike, Hartëzimi i Riskut, Inxhinieri Mjedisore, Planifikim Hapësinor, Zhvillim Ekonomik Vendor), të realizuara në Shqipëri dhe/ose ndërkombëtarisht gjatë 3 (tre) viteve të fundit, me një vlerë totale jo më të vogël se 5 000 000 Lekë.

Titulli i projektit dhe klienti	Fusha/fokusi i detyrave	Rajoni	Periudha	Vlera e kontratës në LEK

Për të verifikuar eksperiencën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm provues:

I. Për eksperiencën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të tregohen vlera, statusi i përmbushjes së kontratës dhe faturat tatimore përkatëse, të plotësuara në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke specifikuar datat, vlerat dhe shërbimet e realizuara.

II. Për eksperiencën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore shitjeje, të plotësuara në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe të deklaruara pranë autoriteteve tatimore, ku të specifikohen datat, vlerat dhe shërbimet e realizuara.

Operatori per reference duhet te plotesoje dhe tabelen e mësipërme për kontratat e ngjashme.

10. Deklaratë nga operatori ekonomik, me anë të së cilës angazhohet për realizimin e plotë të objektit të prokurimit, në përputhje me Termat e Referencës, brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve nga data e nënshkrimit të kontratës.

11. Emri i anëtarit kryesor të stafit përgjegjës për mbështetjen e projektit të mësipërm në selinë e kompanisë suaj;

12. Personi i kontaktit për pyetje

emri:
email:
telefoni: